

- 1- Cila është shuma e paguar nga FSDKSH për kompanitë: 3P Life Logistic, Sani Service dhe Dia Vita në vitet 2020 dhe 2021? Ju lutem, pagesat të jenë të specifikuara për secilen kontratë dhe sipas viteve përkatës.**

000 leke

	Viti 2020	Viti 2021
1- PPP KONTROLLI Mjekësor Baze:	322,322	219,021
2- PPP Sterilizimi i Pajisjeve Kirurgjikale:	1,288,269	1,500,924
3- PPP Dialize:	733,203	747,195

- 2- Përse kompanitë koncesionare që ofrojnë shërbime në sektorin shëndetësor janë paguar për shërbime të pakryera, edhe gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19?**

Pagesa për kompanitë koncesionare realizohet sipas përcaktimeve në kontratat koncesionare. Për periudhën e pandemisë nga ana e Autoritetit është pezulluar kontrata për Kontrollin Mjekësor Bazë.

- 3- Auditimi i brendshëm i FSDKSH-së ka konstatuar se “Mungesa e përmirësimit të kushteve të kontratës ka bërë që Fondi t’i paguajë koncesionarit Dia Vita, vetëm për periudhën Janar-Gusht 2020, një vlerë prej 32,694,835.2 lekë për seancat e parrealizuara sipas projekcionit”. A i keni kërkuar Ministrisë së Shëndetësisë të kryejë përmirësimet e nevojshme në kontratë?**

Në të gjitha rastet e auditimit të Fondit, për rekomandimet e Audituesit, njoftohen nga Fondi të gjitha strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimit.

- 4- Si e shpjegoni faktin se nuk kontrollohet zbatimi i kontratës të koncesionarit Sani Service në lidhje me plotësimin e dokumentacionit mjekësor në repartin e kirurgjisë dhe obsetrikë-gjinekologjisë, çka normalisht rrit mundësinë e faturimeve fiktive nga kompania koncesionare në dëm në financave publike? A keni raportuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë për këtë çështje dhe a ka patur reagime në këtë drejtim?**

Strukturat rajonale të Fondit (përgjegjëse për verifikim dhe pagesën e shërbimit të Sani Service në spitalet e kontraktuara), bëjnë pagesën pas verifikimit të dokumentacionit mjekësor në të gjitha njësitë marrëse të këtij shërbimi. Spitalet mbajnë dhe evidentojnë regjistrin e ndërhyrjeve kirurgjikale dhe raportojnë çdo muaj për realizimin e numrin të ndërhyrjeve kirurgjikale sipas tipologjisë (kompleksitetit të ndërhyrjes). Strukturat monitoruese rakordojnë të dhënat analitike të raportuara nga spitalet me treguesit sipas ndërhyrjeve kirurgjikale.

Në asnjë rast nuk bëhet pagesa e shërbimit pa dokumentacionin mjekësor të miratuar.

- 5- Përse për kompanitë koncesionare që ofrojnë shërbime në sektorin shëndetësorë vijojnë të pranohen dhe likuidohen faturat tatimore mujore, ku përfshihet edhe TVSH, ndërkohë që ky shërbimi duhet të trajtohet si Furnizim i Përgjashtuar nga TVSH?**

Të gjitha shërbimet e cilësuara nga DPT si shërbime shëndetësore, janë të përjashtuara nga TVSH

